

# ATOMO

ASTAR MURI I MIKRONIZUAR PA AROMË PËR SIPËRFAQE TË JASHTME/BRENDSHME SOLVENT FREE

SERIE 884

## PËRSHKRIMI

ATOMO është astar, solvent free që hollohet me ujë, me penetrim të lartë, vecanërisht I përshtatshëm për mbushjen dhe konsolidimin e sipërfaqeve minerale të brendshme dhe të jashtme.

I formuluar me polimerë të përbërë nga grimca fine, është I pajisur me fuqi të lartë penetrimi, I aftë të konsolidojë sipërfaqet murale pjesërisht me pluhur dhe të lyera me shtresa të ndryshme bojë të vjetër.

ATOMO paraqet një zgjidhje alternative të vlefshme për përdorimin e astarit klasik me bazë solventi, me ndryshimin thelbësor që si aplikimi po ashtu edhe tharja zhvillohen në prani të çlirimeve shumë të ulëta të përbërësve organikë të paqëndrueshëm (VOC).

ATOMO përmirëson kohezionin dhe uniformon absorbimin e sipërfaqes duke krijuar sipërfaqen ideale për shtresat pasardhëse të bojës, duke I izoluar nga ambienti alkaline I sipërfaqeve të çimentos dhe të ngjashme.

## ISTRUKSIONE PËR PËRDORIM

I aplikueshëm në:

- Sipërfaqe të trajtuara me sistemin termik "cappotto".
- Suvatime të reja dhe të vjetra
- Sipërfaqe betoni.
- Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.
- Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
- Sipërfaqe me natyrë minerale me kusht që të jenë absorbuese.
- Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin "Përgatitja e sipërfaqes".
- Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta (të sapo suvatuara) dhe me tendencë alkaline, prisni një kohë të përshtatshme maturimi (tharje) përgjithësisht 4 javë.

## KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Natyra e lidhësit: mikroemulsione me pak aromë
- Solventi: ujë
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1:  $1,00 \pm 0,05$  kg/l
- Tempo di efflusso UNI EN ISO 2431:  $46 \pm 3$ "
- Kupa Iso n.3 ne 25 °C
- Raporti I provës N. 3728F2011 Studio ASA - Treviso:
- .Përcaktimi I përbërësve organikë të paqëndrueshëm (VOC): <5,7 mg/kg

.Përcaktimi I Formaldeideve të lira: <1 mg/kg  
-Tharja (25 °C dhe 65% U.R.): prekja pas 30-40 min.; shtresa tjetër pas 2 orësh.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet në suva, gips dhe kartonxhes:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e maturuar (e tharë plotësisht) prej të paktën 28 ditësh.
- Kontrolloni gjendjen e sipërfaqes. Duhet të jetë e qëndrueshme Në të kundërt siguroni konsolidimin me produkte specifike.
- Në prani të mykut, trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
- Hiqni, me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun dhe pluhurat prezente.
- Në prani të bojrave të vjetra në gëlqere ose temperave/bojërave transpirante hiqni pluhurin dhe pjesën e sipërfaqes jo të aderuar, ndërsa shtresat e ciflosura të bojës në gëlqere ose tempera duhet të hiqen komplet duke larë sipërfaqen me ujë të bollshëm dhe duke e fërkuar ose duke përdorur një makinë larëse.
- Në sipërfaqe të brendshme niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, gropëzat, çarjet me TAMSTUCCO 9400006 ose TAMSTUCCO POLVERE 9410110 ose STUCCOFACILE 9560019; Zmeriloni çarjet e stukuara me letër zmerile.
- Mbyllni çarjet me ngjitës (stuko) të përshtatshëm
- Kryeni zbutje në sipërfaqe me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 në bazë të llojit të sipërfaqes.
- Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim.
- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë dhe aplikoni një shtresë ATOMO sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.
- Pas të paktën 2 orësh vazhdoni me aplikimin e produktit përfundimtar (bojës).

### Sipërfaqe betoni:

- Zmeriloni sipërfaqen dhe eliminoni shtresat e ngritura/ciflosura të bojës së vjetër.
- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
- Hiqni pjesët e dëmtuara/ jo mirë të aderuara të çimentos.
- Shufrat metalike të armaturës në sipërfaqe

# ATOMO

ASTAR MURI I MIKRONIZUAR PA AROMË PËR SIPËRFAQE TË JASHTME/BRENDSHME SOLVENT FREE

## SERIE 884

duhet të pastrohen/zmerilohen dhe të trajtohen me BETOXAN PRIMER 9490125 Boiaccia passivante.

-Rivendosni pjesët që mungojnë me zbutësin BETOXAN 400 ose BETOXAN 300 llaç tiksotropik anti-tkurrje me fibra të përforcuara 9490140/130; kryeni ngjitjen përfundimtare me anti-karbonatizuesin anti-tkurrje BETOXAN 200 9490120.

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë dhe aplikoni një shtresë ATOMO sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

-Pas të paktën 2 orësh vazhdoni me aplikimin e produktit përfundimtar (bojës).

Sipërfaqe në material guri ose tulle:

-Hiqni pluhurat dhe pastroni sipërfaqet; në prani të sipërfaqeve të ndotura, të ciflosura etj, realizoni pastrimin me zmerilim, larje me ujë ose pastrim kimik. Është e këshillueshme që të bëhet një provë paraprake për të stabilizuar metodën dhe tipin e pastrimit më efikas.

-Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).

-Në sipërfaqe të thara vazhdoni me aplikimin e 1-2 shtresave të astarit ATOMO sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

## UDHËZIME PËR APLIKIM

-Kushtet e ambientit dhe të sipërfaqes:  
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C

Lagështira relative e ambientit: <75%  
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C

Temperatura e sipërfaqes: <10%

-Shmangni aplikimet në sipërfaqe me kondensim ose që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të diellit.

-Mjetet: pinel, rrul.

-Nr. I shtresave: aplikohen 1-2 shtresa, e njomë mbi të njomë.

-Holluesi: ujë

-Hollimi: varion sipas llojit dhe absorbimit të sipërfaqes.

.Në gips dhe kartonxhes 50 deri në 100%;

.Në suva, veshje cappoto, dhe në praninë e bojrave të vjetra me pluhur nga 100 deri në 200%

.Në beton nga 200 deri në 300%

Sasia e duhur mund të vlerësohet duke shikuar me vëmendje formimin, mbi sipërfaqen e

trajtuar, të një patine opaleshente. Sasi të e tejkaluara mund të formojnë një shtresë kompakte që nuk favorizon aderimin/vendosjen e bojës pasardhëse, anasjelltas një keqaplikim I astarit sjell vështirësi në aplikim dhe si pasojë shtimin e konsumit, ul kapacitetin e vendosjes të finiturës dhe absorbim jo të njëtrajtshëm.

-Pastrimi I mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.

-Shkalla e mbulimit: Sipërfaqet në suva tradicionale, veshjet e modifikuara me rezinë sintetike, gips dhe kartonxhes 15-18 m<sup>2</sup>/liter. Sipërfaqjet në suva me bazë gëlqere ose shumë absorbuese: 8-10 m<sup>2</sup>/liter. Është e këshillueshme që të bëhet një provë paraprake në sipërfaqe specifike për të përcaktuar konsumin.

## NGJYROSJA

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30° C

Temperatura minimale e ruajtjes: +5 ° C

Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)

Cat. H: astar (bazë uji): 50 g/l (2007) / 30 g/l (2010)

ATOMO Përmban max: 30 g/l VOC

Produkti nuk kërkon etiketim sipas D.L. 65 del 14/03/03 dhe modifikimeve/ azhornimeve.

Përdoreni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos I hidhni mbetjet në ambient, I lini të thahen dhe I trajtoni ato si mbetje të veçanta.

Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët. Përdoreni në vende të mirë ventiluara. Në rast të kontaktit me syte, lajini menjëherë me ujë të bollshëm.

Në rast të gëlltitjes, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni enën ose etiketën.

Mos I hidhni mbetjet/ambalazhet në kanalizime, terren.

Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

# ATOMO

ASTAR MURI I MIKRONIZUAR PA AROMË PËR SIPËRFAQE TË JASHTME/BRENDSHME SOLVENT  
FREE  
SERIE 884

## **SPECIFIKIMET**

Astar që hollohet me ujë, pa aromë SOLVENT FREE për sipërfaqe të jashtme/brendshme. Aplikimi, në sipërfaqe të parapërgatitura, për astar akrilik ATOMO kod. 8840001, me bazë mikroemulsione me VOC të ulët I përshtatshëm për mbushjen e sipërfaqeve murale në sasinë e caktuar nga absorbimi I sipërfaqes. Furnizimi dhe instalimi i materialit € ..... për m<sup>2</sup>.

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencat e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*

Eraldi Shpk